

21.03.2017

T1-353-1564C



REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oeveria - Vlada - Government

Komuna e Gllogocit

Opština Glogovac-Municipality of Glogoc

Zyra e Kryetarit



Në bazë të Vendimit nr. 01-351-6530 të datës 09.02.2017 nga Kryetari i Komunës, për caktimin e komisionit për identifikimin dhe konstatimin e zgjerimit në pronë komunale të objekteve pa leje, që kanë destinim zhvillimin e veprimtarisë afariste në qytetin e Drenasit, Komisioni i përbërë nga Fitim Veliqi – Kryesues, Halim Prokshi – Anëtar dhe Vlora Gjinovci – Anëtare, pas verifikimit të gjëndjes në teren dhe shqyrtimit të dokumentacionit me 21.03.2017 sjell këtë:

R A P O R T

I idhur me zgjerimin e lokaleve afariste në hapësirë komunale

Komisioni në përbërje të plotë, në bazë të përshkrimit të detyrate në pikën (III) të vendimit, me datën 22, 23 dhe 24 shkurt 2017 ka inspektuar 25 objekte të ndërtuar në pronë komunale në qendër të qytetit të Drenasit. Gjatë inspektimit është bërë evidentimi i ndërtimit, fotografimi dhe incizimi gjeodezik i objekteve të ndërtuar pa leje dhe hapësirave të uzurpuara, si dhe është kërkuar certifikata e pronësisë së pjesës së objektit me leje, në mënyrë që të evidentohet ndërtimi pa leje në pronë komunale.


Matjet e sipërfaqeve janë bërë nga Gjeodeti, zyrtar në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e Komunës së Drenasit.

Zgjerimi i ndërtimit në pronë publike është trajtuar në këto mënyra: ndërtim i mbyllur me konstruksion monolit, ndërtim i mbyllur me konstruksion montazhë, ndërtim i hapur më konstruksion montazhë, shtrirje më kubëza apo pllaka e hapësirës komunale.

Për të gjitha llojet e ndërtimit në hapsirë komunale kërkohet leje ndërtimore sipas nenit 2 të UJA nr. 08/2013.


Në vazhdim kemi trajtuar se cilin ndërtim dhe sipërfaqe e cila shfrytëzohet nga subjektet afariste.

1. Kafiterja "Fer Bar", me pronar Mehdi Gjoka, blloku I, Drenas, NRB: 80095252



Subjekti afarist "Fer Bar", i cili e ka marr me qera lokalin me sipërfaqe 72.0 m^2 nga NSHBQ "Drenica" në bazë të kontratës nr. 10203/2016 të dt. 11.07.2016, ka zgjeruar pa lej sipërfaqen e lokalit për 133.0m^2 me konstrukcion metalik të lidhur me saldim, mbulesën e punuar me llamarinë të valëzuar dhe plafoni me pllaka knaufi, ndërsa mbyllja në perimetrin e jashtëm me xham me kornizë plastike. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë viti për nevoja afariste. Ky zgjerim i lokalit konsiderohet rindërtim i objektit ekzistues, andaj kërkohet leje ndërtimi për rindërtim të objekteve ekzistuese.


2. Kafiteria "Inn Caffe", me pronar Jeton Sylkaj, NRB: 71052524, blloku II, lokal i nr. O-70315016-00726-2-1-0, rr."14 Qershori", Drenas,



Subjekti afarist "Inn Caffe", i cili e ka marr me qera lokalin me sipërfaqe 79.50m^2 nga Aziz Kukiqi, pronar i lokalit sipas Certifikatës (nr. 08-952-22687 dt. 30.05.2014), ka zgjeruar sipërfaqen e lokalit për 40.0 m^2 me konstrukcion metalik të lidhur me saldim,

mbulesën e punuar me llamarinë të valëzuar dhe plafoni me pllaka knaufi, ndërsa mbyllja në perimetrin e jashtëm me xham dhe kornizë plastike. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë vtitit për nevoja afariste. Gjithashtu bashkangjitur me lokalit ka ndërtuar dyshemenë nga druri, me sipërfaqe 53.0 m^2 , e ngritur një (1) metër nga niveli i tokës, të rrethuar me rrëthojë druri me lartësi një (1) metër përgjatë perimetrit të jashtëm. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist, por nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike gjatë dimrit për shkak të ndërtimit që është bërë nga subjekti afarist.

**3. Kafiterija “Relax Bar 01”, me pronar Bexhet Sylkaj, NRB: 70990466, Blloku I,
rr.”14 Qershori”, Drenas**



Bexhet Sylkaj pronar sipas kontratës me nr. 497/2010 i lokalit afarist me sipërfaqe 75.0 m^2 , ka zgjeruar sipërfaqen e lokalit për 68.0 m^2 me konstruksion metalik të lidhur me saldim, mbulesën e punuar me llamarinë të valëzuar dhe plafoni me pllaka knaufi, ndërsa mbyllja në perimetër me muri dhe xham me kornizë plastike. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë vtitit për nevoja afariste.

Gjithashtu bashkangjitur me lokalit, ka ndërtuar dyshemenë me pllaka betoni me sipërfaqe 78.0 m^2 dhe konstruksionin e kulmit dhe shtyllat me profile metalike të lidhura saldim, ndërsa tri ballët janë të hapura, por të kufizuara më drunj të mbjellurë (pisha) rreth 2m. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist, por nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike gjatë dimrit për shkak të ndërtimit që është bërë nga subjekti afarist.


4. Kafiterija "Fontana Bar", me pronar Petrit Morina, bloku IV, kati përdhese,
"Sheshi i Qytetit", Drenas



Në bazë të kontratës nr. 01-350-13475 dt. 21.09.2012, Komuna e Drenasit i ka dhënë me qera lokalin afarist me sipërfaqe 55 m^2 , (deri me 30.09.2017), pronarit Habib Miftari (Kosova display sh.p.k), i cili ka zgjeruar pa leje sipërfaqen e objektit (lokalit) për 72.0 m^2 në hapësirë komunale, të ndërtuar me konstruksion metalik, mbulesën e punuar me llamarinë të valëzuar dhe plafon nga druri, ndërsa mbyllja në perimetër të jashtëm një pjesë me muri me tulla, ndërsa pjesa me e madhe me xham me kornizë druri, afërsisht të vendosur në çdo metër. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë vitit për nevoja afariste.

Para lokalit "Fontana Bar", në pronë komunale, pronari ka shtruar me pllaka sipërfaqen 131.0 m^2 , e cila është në nivel të sheshit të qytetit dhe është e kufizuar me drunj (pisha) dhe gjelberim me sipërfaqe 29 m^2 . Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist, por nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike gjatë dimrit për shkak të kufizimit me drunj që është bërë nga subjekti afarist.

**5. Kafiteria "Bulevard", me pronar Rahman Bucolli, bloku IV, kati përdhese,
"Sheshi i Qytetit", Drenas**




Pronari i lokalit afarist "Bulevard", Rahman Bucolli, ka zgjruar pa leje sipërfaqen lokalit në dy pjesë të objektit për 123.0m^2 në hapësirë komunale, të ndërtuar me konstruksion monolit, mbulesën e punuar me llamarinë të valëzuar dhe plafoni nga materialet e ngurta, ndërsa mbyllja në perimetër të jashtëm me xham me kornizë alumini, të vendosur në çdo metër. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë viti për nevoja afariste.

Para lokalit "Buleard", në pronë komunale, pronari ka shtruar me kubëza betoni sipërfaqen 45.0m^2 , e cila është në nivel të sheshit të qytetit dhe është e kufizuar me drunj (pisha). Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist, por nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike gjatë dimrit për shkak të kufizimit me drunj që është bërë nga subjekti afarist.


8. Restaurant "City Grill", pronari Ekrem Elshani, rr. "14 Qershori", Drenas



Ekrem Elshani, pronar i lokalit afarist me sipërfaqe 60.0 m^2 , ka zgjeruar pa leje sipërfaqen e objektit (lokalit) për 176.0 m^2 në hapësirë komunale, të ndërtuar me konstruksion metalik të lidhur me saldim, mbulesën e punuar me llamarinë të valëzuar, ku një pjesa e tij ka mundësi hapje, ndërsa myllja në perimetër të jashtëm një pjesë me muri nga druri, ndërsa pjesa me e madhe me xham me kornizë nga alumin afersisht të vendosur në cdo metër. Në katin mbi përdhesë, me konstruksion metalik dhe myllje të vendosur në cdo metër. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë vitit për nevoja afariste.





Bashkangjitur me lokalini, në pronë komunale, ka ndërtuar dyshemenë nga druri me sipërfaqe 69.0 m^2 , e cila është e ngritur nga niveli i tokës dhe është e kufizuar me drujë (pisha) dhe një objekt - shanku nga konstruksioni i drurit me sipërfaqe 17m^2 . Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-veshtë nga subjekti afarist, por nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike gjatë dimrit për shkak të ndërtimit që është bërë nga subjekti afarist.




Gjithashtu pronari i lokalit "City Gril", ka ndërtuar parkingun me kubëza betoni me sipërfaqe 360 m^2 , në pronë komunale dhe ka vendosur gjeneratorin me sipërfaqe 7 m^2 . Sipërfaqja e parkingut shtrihet edhe në pjesën e trotuarit, me këtë pengohet lëvizja e lirë në trotuar. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë vitit për nevoja afariste.


9. Restaurant "Peshkopja"- S. Autobusëve, Selman Sinani, rr. "14 Qershori", Drenas




Selman Sinani, sipas vërtetimit nr. 339 dt. 01.11.2005, të lëshuar nga KAN "RAMIZ SADIKU" Prishtinë, pronar i lokalit afarist me sipërfaqe 143 m^2 , ka zgjeruar pa leje sipërfaqen e objektit (lokalit) për 201.0 m^2 , në dy ballët e tij në pronë komunale, të ndërtuar me konstrukcion metalik, mbulesën e punuar me llamarinë, plafonin e punuar me materiale të ngurta, ndërsa mbyllja në perimetër të jashtëm me xham me kornizë nga alumin të vendosur çdo 2m. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë vitit për nevoja afariste.



Pronari i lokalit afarist Selman Sinani, në pjesën jug-perëndimore, bashkëngjit me lokalin, ka ndërtuar një terasë verore me sipërfaqe 21.0m^2 , e hapur në dy balle, ndërsa në dy ballët tjera ndodhen muret e lokalit, konstruksioni i kulmit me profile metalike, mbulesa me llamarinë të valëzuar, plafoni me materiale të ngurta, dysheme nga druri e ngritur rreth 10cm . Kjo pjesë nga ana jugore është e rrethuar me drunj dhe më rrëthojë nga druri me lartësi 1.5m që përmban reklamen e subjektit afarist. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist, por nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike gjatë dimrit për shkak të ndërtimit dhe kufizimit që është bërë nga subjekti afarist.




Para lokalit, në pronë komunale, pronari ka ndërtuar dyshemenë me pllaka betoni me sipërfaqe 170 m^2 , të ngritur nga niveli i tokës rreth 1m , të kufizuar me drunj (pisha) dhe sipërfaqe gjelbëruese. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist, por nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike gjatë dimrit për shkak të ngritjes së kësaj sipërfaqe nga niveli i terenit dhe të kufizimit me muri dhe drunj që është bërë nga subjekti afarist.




Për rrith objektit të restaurant "Peshkopia", në pronë komunale, pronari ka ndërtuar hapësirë gjelbëruese me bari dhe drunj, me sipërfaqe 333.0m^2 , që është ngritur rreth 1.0 m nga niveli i terenit me muri nga betoni i veshur me gurë të gdhendur dhe një pjesë me rrethojë nga druri me lartësi 1.5 m. Brenda kësaj hapësire janë të ndërtuara edhe dy fontana me sipërfaqe 28m^2 dhe trotuare me sipërfaqe 50m^2 . Kjo sipërfaqe nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike për shkak të ndërtimit dhe kufizimit që është bërë nga subjekti afarist.

10. Kafiteria "Trip Bar", pronari Avni Saliuku nga Gradica, ID:1235055640,
"Sheshi I Qytetit", Drenas




Pronari, (qiramarrësi) i lokalit afarist "Trip Bar", ka zgjeruar pa leje sipërfaqen e objektit (lokalit) për 79.0 m^2 në hapësirë komunale, të ndërtuar me konstruksion metalik të lidhur me saldim, mbulesën e punuar me llamarinë të valëzuar, dyshemeja me beton e ngritur nga niveli i sheshit rrëth 20cm. Lokali në pjesën e zgjeruar është i hapur në tri anët. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist, por nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike gjatë dimrit për shkak të ndërtimit që është bërë nga subjekti afarist.

**11.Lokal “jo aktiv për momentin”, pronari Habib Bajraktari, “Sheshi i Qytetit”,
Drenas**



Në hapësirën komunale, para lokalit të pronarit Habib Bajraktari, është ngritur me beton dyshemeja me sipërfaqe $41m^2$ dhe është kufizuar më drunj(pisha) me lartësi 2m në pjesën nga sheshi i qytetit. Kjo hapësirë komunale nuk është duke u shfrytëzuar pasi që lokali është i mbyllur (jo aktiv), por kjo hapësirë nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike gjatë dimrit për shkak të ndërtimit që është bërë nga subjekti afarist.

12.Dyqani “Melisa”, pronari Isuf Krasniqi, “Sheshi i Qytetit”, Drenas




Në hapësirë komunale, para lokalit të pronarit Habib Bajraktari, është ngritur me beton dyshemeja me sipërfaqe $44m^2$ dhe është kufizuar më drunj(pisha) me lartësi 2m në pjesën nga sheshi i qytetit, si dhe janë vendosur pengesa betoni në dy anët. Kjo hapësirë komunale nuk është duke u shfrytëzuar për momentin për afarizëm, por kjo hapësirë nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike për shkak të pengesave të vendosur dhe të ndërtimit që është bërë nga pronari.

13. Mobil shop "TONI", Pronari i objektit Habib Bajraktari "Sheshi i Qytetit", Drenas





Në hapësirë komunale, para lokalit të pronarit Habib Bajraktari (që shfrytëzohet nga Mobi Shop "Toni") është ngritur me beton dhe një pjesë gjelbrim dyshemeja me sipërfaqe 21m^2 dhe është kufizuar më drunj(pisha) me lartësi 2m në pjesën nga sheshi i qytetit, si dhe janë vendosur pengesa betoni në dy anë. Kjo hapësirë komunale nuk është duke u shfrytëzuar për momentin përafarizëm, por kjo hapësirë nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike për shkak të ndërtimit dhe kufizimit që është bërë nga pronari.

14. Qebaptore "Toni", pronari i subjektit Labinot Brahimi, NRB:71206718, Pronari i objektit Habib Bajraktari "Sheshi i Qytetit", Drenas



Qiramarrësi Labinot Brahimë, i lokalit afarist qebaptore "TONI", ka zgjeruar pa leje sipërfaqen e objektit (lokalit) për 48.0 m² në hapësirë komunale, të ndërtuar me konstruksion metalik të lidhur me saldim, që pritet t'i vendos mbulesë najloni, dyshemeja nga betoni e ngritur nga niveli i sheshit rrëth 20cm dhe perimetri i jashtëm i pjesës së zgjeruar të lokalit është i hapur në tri anët, i rrethuar me rrëthojë druri me lartësi 1m dhe me drunj (pisha) nga pjesa e sheshit. Kjo sipërfaqë shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist, por nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike gjatë dimrit për shkak të ndërtimit që është bërë nga subjekti afarist.

15. Qajtore "Naimi", me pronar Naim Salihu, rr. "Shaban Shala", Drenas



Pronari Naim Salihu nga fsh. Shtuticë, i lokalit afarist çajtore "Naimi", ka zgjeruar pa leje sipërfaqen e objektit (lokalit) për 56.0 m^2 në hapësirë komunale, të ndërtuar me konstruksion druri dhe kulmi me konstruksion nga druri, ndërsa mbulesën me tegolla, ndërsa mbyllja në perimetër të jashtëm me xham me kornizë druri, afërsisht të vendosur në çdo 1.5 m . Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë vitit për nevoja afariste.

16. Gjelltore "Altini", me pronar Hasa Kurrumeli, rr. "Shaban Shala", Drenas



Pronari Hasa Kurrumeli, i subjektit afarist gjelltore "Altini", ka kufizuar hapësirën komunale me sipërfaqe 23m^2 para lokalit të tij me vazo nga betoni. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist.

17. Pasticeria "LEO", me pronar Luan Elezi, rr. "Shaban Shala", Drenas



Pronari i subjektit afarist "LEO", Luan Elezi, ka kufizuar hapësirën komunale me sipërfaqe $19m^2$ para lokalit të tij me rrethojë me profile metalike në të dy anët. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist.




18. Restaurant "ANA", me pronar Faik Kastrati, rr. "Shaban Shala", Drenas



Pronari, i subjektit afarist "ANA", Faik Kastrati, ka kufizuar hapësirën komunale me sipërfaqe $29m^2$ para lokalit të tij, duke ndërtuar dysheme nga betoni dhe ka vodosur tepih. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist.


19. Kafiteria "Lips Bar", me pronar Jeton Istogu, rr. "Adem Mulaj", Drenas



Pronari i lokalit (qiramarrësi), ka zgjeruar pa leje sipërfaqen e objektit (lokalit) në katin përdhese, për 5.0 m^2 në hapësirë komunale. Pronari ka mbyllur hapësirët nën konzolla (ballkone) me xham me kornizë nga alumini. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë vitit për nevoja afariste.


Bashkangjitur me lokalin, në pronë komunale, pronari i lokalit ka shtruar me kubëza betoni sipërfaqen 65.0 m^2 , që është e ngritur nga niveli i tokës dhe është e kufizuar me drunj (pisha), të cilët kanë lartësi 1.0 m dhe një pjesë e rrethjes nga druri me gjatësi 6m dhe lartësi 2.5 m. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë vjeshtë nga subjekti afarist, por nuk mund të shfrytëzohet si hapësirë publike gjatë dimrit për shkak të ndërtimit dhe kufizimit që është bërë nga subjekti afarist.

20. Market "Ledri", NRB: 70988372, rr."Adem Mulaj", Drenas




Pronari i lokalit afarist (sipas Certifikatës 952-8359 dt. 27.02.207) me sipërfaqe 6.0 m^2 , Petrit Kukaj, ka zgjeruar pa leje sipërfaqen e objektit (lokalit) për 2.0 m^2 në hapësirë komunale, të ndërtuar me konstruksion metalik, mbulesën e punuar me llamarinë të valëzuar, ndërsa mbyllja në perimetër të jashtëm me xham me kornizë alumini, të vendosur në çdo metër. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë vitit për nevoja afariste.

21. Restaurant "Juvenila", me pronar , rr."Jasharve", Drenas



Ndërtimi i objektit të hapur montazh me profile metalike me sipërfaqe $30m^2$ është bërë pa leje ndërtimore në zonën e rrugës që është në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës.

22. Ëmbëltore "ENI", me pronar Lulzim Hasi, "Qendra Tregtare", rr. "14 Qershori", Drenas




Pronari, i subjektit afarist "ENI", Lulzim Hasi, ka ndërtuar dyshemenë me kubëza betoni në hapësirë komunale para lokalit të tij me sipërfaqe $29m^2$, që është e ngritur nga niveli i terenit rreth 15cm dhe e kufizuar në një pjesë të tij me drunj (pisha). Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist.

**23. Pastiqeria "Muli", Flamur Nishori, "Qendra Tregtare", rr. "14 Qershori",
Drenas**



Pronari i lokalit në Qendrën Tregtare, ka ndërtuar dyshemenë nga betoni në hapësirë komunale para lokalit të tij me sipërfaqe $36m^2$, që është e kufizuar me rrethojë nga druri lartësi 1.0 m. Kjo sipërfaqe shfrytëzohet për afarizëm gjatë sezonit pranverë-verë-vjeshtë nga subjekti afarist.


**24. D.P.T "Fitimi Trade", me pronar Qamil Dragaj, Bloku II, rr. "14 Qershori",
Drenas**



Pronari Qamil Dragaj, ka zgjeruar në hapësirë komunale pa leje sipërfaqen e objektit (lokalit) për $17 m^2$, në dy pjesë te lokalit, të ndërtuar me konstruksion monolite nga betoni, mbulesën e punuar me llamarinë të valëzuar, ndërsa mbyllja në perimetër të jashtëm me muri dhe një pjesë xham me kornizë nga pvc, të vendosur në çdo metër. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë viti për nevoja afariste.

Me aktvendim nr. 08-353-2495 dt. 16.06.2008, pronarit Qmil Dragaj i është lejuar shendrimi i objektit banesor me sipërfaqe $79.50m^2$ në lokal afarist.

25. Market "Cimi", Blloku II, rr. "14 Qershori", Drenas



Pronari i market "CIMI", ka zgjeruar në hapësirë komunale pa leje sipërfaqen e objektit (lokalit) për $38 m^2$, të ndërtuar me konstruktion metalik, mbulesën e punuar me llamarinë të valëzuar, ndërsa mbyllja në perimetër të jashtëm me xham me kornizë nga alumini, të vendosur në çdo metër. Këtë sipërfaqe subjekti afarist e shfrytëzon gjatë gjithë vitit për nevoja afariste.

DATA	2017
VITI	2016
KODI	0162
DETALJAT	QENDRA TREGTARE
LOKACIONI	KOMORAN
MATERIALI	SHFRTZIMI
DETALJAT	DRENASIT DHE NDERIMIT DHE DESTINIMIT PËR VITIN 2017

Tabela 1. Lista e subjekteve afarisë që shfrytëzojnë hapësirat publike në qytetin e Drenasit dhenë Komoran, si dhe klasifikimi i shfrytëzimit sipas llojit të ndërtimit, për vitin 2017

Nr.	Subjekti afarist	Rruga	Ndërtim i mbyllur, shfrytëzim i përhershëm (m ²)	Ndërtim montazh me hapje, shfrytëzim veror (m ²)	Dysheme nga betoni (druri) apo me pilaka betoni (qeramike) shfrytëzim veror (m ²)	Hapësirë gjelbëruese e rrëthuar (m ²)	Hapsira publike e paguar (e llogaritur) për shfrytëzim gjatë vitit 2016
							Ndërtim montazh me hapje, shfrytëzim veror (m ²)
1	Kafiteria-Fer Bar	Sheshi i Qytetit	133			6	62
2	Kafiteria-Inn Caffe	14 Qershori	40	53			86
3	Kafiteria-Relax Bar	Sheshi i Qytetit	68	78			75
4	Kafiteria-Fontana	Sheshi i Qytetit	72		131	29	74
5	Kafiteria-Bulevardi	Sheshi i Qytetit	123		45		24
6	Picieria – La Pizza	Sheshi i Qytetit			80	45	
7	Kafiteria – Bling	Sheshi i Qytetit	62				77
8	Rest City Grill	14 Qershori	186	17	69+(360 parking)	12	57
9	Rest-Peshkopja	S. Autobusëve	201	21	170	7 (generatori) 333+(28 fontanë+50 trotuare)	152
0	Kafiteria Trip Bar	Sheshi i Qytetit					133
1	Habib Bajraktari	Sheshi i Qytetit					
2	Dygani "Melisa"	Sheshi i Qytetit					
3	Mobi shop-Toni	Sheshi i Qytetit					
4	Qebaptore - Toni	Sheshi i Qytetit					
5	Cajtore "Naimi"	Shaban Shala	48				
6	Gjettore "Altini"	Shaban Shala	56				
7	Pasticeria "LEO"	Shaban Shala	5				
8	Rest ANA	Shaban Shala					
9	Kafiteria-Lips Bar	Adem Mulaj					
10	Market – Ledri	Adem Mulaj	5				
11	Rest-Juvenilia	Jasharajve	2				
12	Embeltore-Eni	Qendra Tregtare					
13	Pasticeria - MULI	Qendra Tregtare					
							30
							36
							40

24	D.P.T Fitim i Trade	14 Qershori	17				
25	Market - CIMI	14 Qershori	38				Nuk ka paguar
26	NSH "EURO-B ALB	Komoran	51	53	1220	1170	Nuk ka paguar
	Ordinanca "Profesional Dent"	Bloku II, 14 Qerishori	20			172	
	Totali i shfrytëzimit të sipërfaqeve publike	1079	349	2393	1689	1158	

Drenas, me 21.03.2017

Komisioni:



1. Fitim Veliqi, Kryesues
2. Halim Prokshi, Anëtar
3. Vlora Gjinovci, Anëtar